

LIGJ
Nr. 123/2020

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 92/2014, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E
SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet shtesa si më poshtë:

Neni 1

Pas pikës 8, të nenit 49, “Shkallët e reduktuara”, shtohet pika 9 me këtë përmbajtje:

“9. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të punimeve të ndërtimit për investimet shtetërore të klubeve sportive/federatave sportive apo për investimet e subjekteve private në infrastrukturën sportive, të përcaktuar në legjislacionin e fushës për sportin, është në nivelin 6 për qind.”.

Neni 2

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2021.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 15.10.2020